



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD

Numri i lëndës: 2024:099484
Datë: 10.03.2025
Numri i dokumentit: 06958987

C.nr.42/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Dega në Novobërdë- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Gazmend Ajvazi, me bashkëpunëtoren profesionale Laureta Shala, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.M nga fshati Ll, komuna e N., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avdullah Gashi, avokat nga Gjilani, rruga "Marie Shllaku" p.n. kundër të paditurës Komuna e Novobërdës-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i pagës shtesë për punën gjatë vikendit, vlera e kontestit 112.04 euro, jashtë seancës, me datë 07.03.2025 mori këtë,

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi e pabazuar kërkesëpadia e paditësit A.M nga fshati Llabjan, komuna e Novobërdës, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Novobërdës-Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të pagës shtesë për punë gjatë vikendit, për periudhën kohore 15.10.2022-28.01.2023 t'ia paguaj shumën prej 112.04 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, më datë 29.03.2024 kanë paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës për kompensimin e pagës shtesë për punën gjatë vikendit, në vlerë të kontestit prej 112.04 euro.

Në padi kanë theksuar se i njëjti është në marrëdhënie pune te e paditura si mësimdhënës-drejtor pranë institucionit arsimor SHFMU "A." në fshatin Ll. Bazuar në nenin 56 të Ligjit të Punës, ka theksuar se paditësit i takon kompensimi për 50 % në orë për punë gjatë fundjavës, ndërsa i njëjti ka qenë i detyruar të punojnë vikendeve për periudhën 15.10.2022 deri me 28.01.2023, janë mbajtur 8 ditë mësimi (të shtuneve) nga 8 orë, gjithsejt 64 orë, të zëvendësuara për shkak të grevës së mbajtur, mirëpo nuk është kompensuar për këtë punë. Gjykatës i ka propozuar të

aprovjê të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyrojê të paditurën që t'ia kompenojê shumën e përgjithshme prej 112.04 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura me shkresën e datës 26.04.2024 parashtuar përgjigje në padi lidhur me çështjen kontestuese, duke e kontestuar padinë në tërësi dhe duke i mohuar pretendimet e paditësit, për shkak se i njëjti kërkon kompensimin për punën gjatë fundjavës pa bazë ligjore, duke shtuar se Kontratat Kolektive të Arsimit të vitit 2017 dhe 2021 nuk paraqesi bazë ligjore për arsye se ekziston njoftimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës-Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit për ndërprerjen e kontratës kolektive me 22 janar 2021. Sa i përket kompensimit për punë gjatë vikendit (pandemi), bazuar në vendimin e MASHT-it, nr.01b/292 të datës 28.09.2021 paditësit kanë qenë të obliguar që ditët e humbura punuese gjatë kohëzgjatjes së pandemisë t'i zëvendësojnë, e në rastin konkret kemi të bëjmë me orë të zëvendësuara, e jo orë shtesë. Ka konsideruar se paditësi nuk ka shtjerrë paraprakisht mjetet e brendshme të ankimimit, bazuar në nenin 78, 79 dhe 82 të Ligjit të Punës. Gjykatës i ka propozuar të vlerësojë parashkrimin e tyre, bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës dhe kërkesave periodike nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 399, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia. Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”.

Nga përmbajtja e kontratës së paditësit, përkatësisht nenit 4, pika 1, nënpika 1.1 të saj, thuhet se “I punësuari është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/saj të punës”.

MASHT, duke vepruar konform Ligjit për Arsimin Parauniversitar, ka nxjerrë akt nënligjor për të përcaktuar planprogramin mësimor, konkretisht me datë 20.08.2021 ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ 07/2021, për Kalendarin e Vitit Shkollor 2021-2022.

Në nenin 1 të këtij udhëzimi përcaktohet se “Ky udhëzim administrativ ka për qëllim të përcaktoj fillimin dhe mbarimin e vitit shkollor, respektivisht të vitit mësimor, sipas niveleve, pushimin dimëror, pushimin pranveror, festat publike për nxënësit e shkollave fillore, klasave parafillore, shkollave të mesme të ulëta, shkollave mesme të larta, institucioneve parashkollore dhe qendrat burimore për mësim dhe këshillim”.

Në nenin 9 të këtij udhëzimi përcaktohet se “Ditët dhe javët e obliguara të mësimimit dhe të punës:
1. Për nxënësit e shkollës së mesme të lartë-maturrantët, janë të obliguar 160 ditë mësimi,

tridhjetedy (32) javë, 2. Për nxënësit e klasave 9, 10 dhe 11-të, janë të obliguara, 175 ditë mësimi. 35 javë, 3. Për nxënësit e klasave 1-8 dhe fëmijët parafillor, janë të obliguara 185 ditë mësimi, 37 javë, 4. Institucionet parashkollore, duhet të marrin për bazë festat zyrtare në pajtim me nenin 7 të këtij udhëzimi, 5. Pushimet verore për institucionet parashkollore rregullohen nga institucionet parashkollore në bashkëpunim me DKA-në, gjatë periudhës kohore 1 korrik deri më 15 gusht, ku brenda kësaj periudhe kohore planifikojnë pushimin vjetor në bazë të ligjit të punës, 6. Në Qendrat Burimore për mësim dhe këshillim me konvikt, në rast se festa është gjatë ditëve të punës, u lejohet të planifikojnë zëvendësimin e mësimi, pa humbur nga ditët dhe javët e obliguara për mësim, 7. Për çdo ndryshim të kalendarit shkollor, MASHTI merr vendim të veçantë”, pra nga përkufizimi i kësaj dispozite, del se Mashti me akt nënligjor përcakton ditët dhe javët e obliguara të mësimi dhe të punës dhe se ndryshimi i këtij Udhëzimi, sipas nenit 8 par. 7 të tij, bëhet me vendim”.

Gjatë vijimit të kalendarit shkollor 2021/22, për shkak të gjendjes së pandemisë Covid-19 janë humbur 18 ditë mësimore dhe mësimdhënësit nuk i kanë përmbushur detyrimet që dalin nga kontratat e tyre të punës, përkatësisht nuk kanë implementuar Udhëzimin Administrativ nr.07/2021 për Kalendarin e Vitit Shkollor 2021-2022.

Pas përfundimit të gjendjes pandemike, MASHT konform nenit 8 par. 7 të UA.nr.07/2021, ka nxjerrë vendimin numër 01B/292 të datës 28.09.2021 për kompensimin e ditëve të mësimi të humbura për shkak të gjendjes me Pandeminë Covid-19, me të cilin vendim ishte përcaktuar që të kompensohen 18 ditët e mësimi të humbura, ashtu që 10 ditët e mësimi zëvendësohen mbahen të shtunave dhe janë përcaktuar datat që nga muaji tetor 2021 deri në muajin shkurt të vitit 2022.

Nga të lartcekurat, gjykata vërteton se pretendimi i paditësit për kompensimin pagës shtesë për shkak të punës më të gjatë se sa orari i plotë i punës, është në tërësi i pabazuar, për arsye se orët e punës për paditëset si në kontratën e tyre të punës, janë përcaktuara në Udhëzimi Administrativ nr.07/2021 për Kalendarin e Vitit Shkollor 2021-2022 dhe në vendimin me numër 01B/292 të datës 28.09.2021 për kompensimin e ditëve të mësimi të humbura për shkak të gjendjes me Pandeminë Covid-19, ku për paditëset si mësimdhënëse të klasave 1-8-të, kanë qenë të përcaktuara nga 184 ditë mësimi, (37) javë, ndërsa në kontratën e tyre të punës janë përcaktuar nga 20 orë mësimi në javë, përkatësisht 40 orë pune në javë, andaj paditëset me asnjë provë nuk kanë argumentuar faktin se të njëjtat kanë punuar më gjatë se sa orari i punës së përcaktuar në UA.nr.07/2021 dhe në kontratën e tyre të punës, e si rrjedhojë nuk mund të zbatohet neni 56 i Ligjit të Punës për kompensimin e punës jashtë orarit, sepse paditëset me punën e realizuar gjatë të shtunave të periudhës tetor 2021 – Shkurt 2022, nuk kanë punuar orë shtesë, por të njëjtat kanë zbatuar vetëm detyrimin e tyre për të përmbushur orët e tyre mësimore, të përcaktuara nga kontrata e punës, e në të cilën kontratë nuk janë të përcaktuara ditët e javës brenda të cilave duhet të përmbushen orët mësimore, por vetëm fondi i orëve mësimore, andaj me vendimin për kompensimin e ditëve të mësimi të humbura për shkak të gjendjes me Pandeminë Covid-19, nuk nënkupton faktin se paditëset në mënyrë burimore kanë punuar orë më tepër se sa ato të përcaktuar në UA.nr.07/2021, si dhe fakti se ato ka punuar ditëve të shtune, në asnjë formë nuk ka cenuar të drejtat e tyre që rrjedhin nga Ligji i Punës.

Nga kjo, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke refuzuar në tërësi të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, pasi përkundër suksesit të të paditurës në procedurë, e njëjta nuk i kërkoi shpenzimet e procedurës.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË NOVOBËRDË
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.42/24, më datë 07.03.2025

Gjyqtari,
Gazmend Ajvazi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit, përmes këtij Gjykate.